

Dt. 02/06/ 2024

Akt Themelimi

I shoqerise tregtare "ORO TRADE" Sh.p.k.

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit" , te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 , " Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 "Per Q.K.R dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare , me vullnetin e tij te lire , te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi une, Znj. NILÛFER UYAN , mbajtes I kartes se identitetit me nr U23878954 si dhe ortaku I vetem :

individ me pergjegjesi te kufizuar, banues ne Tirane , krijoj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "ORO TRADE" sh.p.k me akt themelimi si vijon :

Formulimi

Neni 1

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur ' **ORO TRADE** ' sh.p.k . Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqipetar , ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega . Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues .

Selia e Shoqerise

Neni 2


Selia e shoqerise tregtare private "**Rruga Hamid Shijaku, Kashar, zona Kadastrale 2105, Nr pasurie 976/16, Tirane.**" Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj , te hape zyra perfaqesie , dege , te krijojte filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise , vetem me vendim te asamblese dhe ortakut te vetem .

Objektivi I Veprimtarise

Neni 3

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat:

- Prodhim dhe shitblerje produktesh te ndryshme, konsulence tregtare, studime tregu, perfaqesim markash, eksport- import, produksion grafik, video dhe audio, produksion dokumentare, produksion spotesh promocionale, filma me metrazh te shkurter, filma me metrazh te gjate, marredhenie me publikun, aktivitete promocionale, organizim eventesh, publicitet ne median elektronike, te shkruar etj. Tregeti nderkombetare produktesh ushqimore dhe jo ushqimore, konsulence tregu, konsulence marketingu , kerkime tregu, menaxhim fushatash publicitare dhe cdo aktivitet ne fushen e marketingut, promosionit dhe publicitetit.



Neni 4

Kohezgjatja e Shoqerise

Kohezgjatja e shoqerise do te jete deri ne vitin 2050. Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkakut .

Neni 5

Kapitali I Shoqerise

Kapitali fillestar I shoqerise private ' **ORO TRADE** ' sh.p.k do te jete 2 000 000 LEKE (Dy milione). Kapitali eshte 100 % nga kuotat e ortakut te vetem , e ndare ne 1 kuote . Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet (por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestar).

Neni 6

Drejtimi I Shoqerise

Shoqeria do te drejtohet nga administratori I saj , ortakut I vetem dhe perfaqesuesi ligjor I saj . Ai eshte perfaqesuesi I Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj . Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues I pajisur me prokure te posacme .

Neni 7


Te ardhurat neto te shoqerise I takojne ortakut te vetem.

Neni 8

Ortakut I vetem themelues ka te drejte te emeroje dhe administratore te tjere te vlerave materiale . Ka te drejte te caktojte financiere , likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtojte persona te tjere si ortakut .

Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar ne Gjykatën e Rethit Gjyqesor Tirane.



Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme , me tekstin rreth saj .

Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqipetar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri .

Neni 12


Akti I themelimit u perpilua ne 2 kopje , per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise '**ORO TRADE**' sh.p.k.

Akti I themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaku i vetem.

Ortaku themelues I

' ORO TRADE ' sh.p.k

NILÜFER UYAN



STATUTI I SHOQERISE

"ORO TRADE" SH.P.K

I. KRIJIMI, FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI

NENI 1

Sot, ne daten 02/06/2021 eshte krijuar Shoqeria "**ORO TRADE**" Sh.p.k., me seli ne adresen "**Rruga Hamid Shijaku, Kashar, zona Kadastrale 2105, Nr pasurie 976/16, Tirane.**". Ky statut i hartuar dhe i nenshkruar nga Ortaku i Vetem i saj Znj. NILÜFER UYAN .

NENI 2

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, te **Ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"**. Shoqeria ka vulen dhe emrin e saj.

NENI 3

Emertimi i Shoqerise eshte "**ORO TRADE**" Sh.p.k.

NENI 4

Shoqeria "**ORO TRADE**" Sh.p.k. do te kete per objekt te veprimtarise :

- Prodhim dhe shitblerje produktesh te ndryshme, konsulence tregtare, studime tregu, perfaqesim markash, eksport- import, produksion grafik, video dhe audio, produksion dokumentare, produksion spotesh promociionale, filma me metrazh te shkurter, filma me metrazh te gjate, marredhenie me publikun, aktivite promociionale, organizim eventesh, publicitet ne median elektronike, te shkruar etj. Tregeti nderkombetare produktesh ushqimore dhe jo ushqimore, konsulence tregu, konsulence marketingu , kerkime tregu, menaxhim fushatash publicitare dhe cdo aktivitet ne fushen e marketingut, promocionit dhe publicitetit.

NENI 5

Selia ligjore e shoqerise eshte ne adresen: **Rruga Hamid Shijaku, Kashar, zona Kadastrale 2105, Nr pasurie 976/16, Tirane.** Ajo mund te hape filjale, dege e zyra ne te gjithë vendin ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi. Shoqeria ka vulen dhe emrin e saj.

NENI 6

Kohe zgjatja e shoqerise eshte percaktuar deri ne vitin 2050 .



II. KAPITALI THEMELTAR

NENI 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 2 000 000 (Dy milione) leke dhe i derdhur ne seline e shoqerise. Kapitali eshte 100 % nga kuotat e ortakut te vetem i ndare ne 1 kuote.

NENI 8

Me vendim te ortakut, kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet kontributeve ne para ose ne natyre. Po keshtu mund te zvogelohet kur kjo gje motivohet nga humbjet qe peson shoqeria.

NENI 9

Pjeset e kapitalit. Themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie, ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve, ndermjet bashkeshorteve si dhe ndermjet paraardhesve e pasardhesve.

NENI 10

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transfeohen te treteve me miratim te Ortakut te Vetem Znj. NILÛFER UYAN. Po keshtu mund te perfshihet ne shitblerje aksionesh me shoqeri te tjera duke u kthyer ne filjale, shoqeri kontrolluese ose e kontrolluar nga nje shoqeri tjeter.

NENI 11

Ne çdo rast, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar, duhet te vertetohet me nje akt noterial.

III. MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI, KOMPETENCAT DHE KONTROLLI I SHOQERISE

NENI 12

Te gjitha vendimet e shoqerise merren nga Ortaku i Vetem duke u bazuar ne dispozitat ligjore te percaktuara ne ligjin " Per shoqerite tregetare", ne lidhje me marrjen e vendimeve. AI VENDOS VETE KRYESISHT PER KETO ÇESHTJE:


-Merr vendime per ndryshimin e formes, emertimit, selise, kapitalit, veprimtarise se shoqerise, ndryshim ne zoterimin e kuotave te kapitalit te shoqerise, pranim te ortakeve, pjesmarrjen e shoqerise ne shoqeri te tjera dhe anasjelltas

-Miraton raportet financiare e bilancin vjetor, vendos per perdorimin e fitimit,organizimin e shoqerise dhe per prishjen e saj.

-Emerton dhe shkarkon administratorin, likujdatorin, ekspertet kontabel si dhe drejton veprimtarite e rendsishme te shoqerise.

- Emerton dhe shkarkon drejtuesin teknik te shoqerise

Marrja e vendimeve realizohet me iniciativen e Ortakut te Vetem ose me kerkese te administratorit, te ekspertit kontabel, te cilet ne kete rast duhet ti njoftojne Ortakut projektin dhe relacionin shpjegues 15 dite perpara takimit.



NENI 13

Shoqeria administrohet nga nje person fizik qe mund te jete vet Ortaku i Vetem ose nje person tjetër i emruar ne kete detyre.

Administratori i Pare i Shoqerise emerohet znj. NILÜFER UYAN me nr karte identiteti U23878954 .

Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer veprimet e administratorit, ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj, nepermjet kompetencave te percaktuara ne kete statut.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem.

Kohezgjatja e mandatit te administratorit eshte per 5 vite financiare radhazi dhe mund te perseritet. Mandati perfundon perpara ketij afati kur administratori nuk ploteson kushtet per te kryer kete detyre, jep doreheqjen ose shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem a nga nje vendim gjykate.

NENI 14

Administratori eshte pergjegjes, sipas rastit, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

NENI 15

Disa nga kompetencat qe i jepen administratorit jane:

- Te siguroje drejtimin e mire te veprimtarise tregetare te shoqerise.
- Te administroje pasurite e shoqerise.
- Te perfaqesoje shoqerine ne maredheniet me te trete.
- Te perfaqesoje shoqerine ne maredheniet me organet e institucionet shteterore, para organeve gjyqesore vete ose duke autorizuar persona te tjere kopetent.
- Te kryeje veprime juridike ne emer e per llogari te shoqerise me te tretet si: te lidh kontrata, te kryej veprime bankare te ndryshme si celje llogarish, marrje kredie, transferta etj.

NENI 16

Kontrolli i veprimtarise ekonomiko-financiare te shoqerise realizohet me vendim te Ortakut te Vetem.

IV. VITI FINANCIAR DHE LLOGARITE VJETORE

NENI 17

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht nga kjo, viti i pare financiar ka filluar ditën e themelimit te shoqerise si person juridik.

NENI 18

Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi veprimtarine e vitit financiar te hartuara nga administratori dhe eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga Ortaku i Vetem, brenda nje afati prej 6- muaj nga mbyllja e vitit financiar.

NENI 19

Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda dates 31 Mars te vitit pasardhes.



NENI 20

Fitimet neto te realizuara nga veprimtaria e shoqerise, mbasi te jene zbritur te gjitha shpenzimet e kryera, detyrimet fiskale, rezerva e domosdoshme etj., i shperndahen Ortakut ose me vendim te tij mund te perdoren per investime, nxitjen e veprimtarise tregetare, reklama dhe per çdo qellim tjetër te ligjshem dhe qe i sherben shoqerise.

NENI 21

Shoqeria ka te drejten e perdorimit lirisht te fitimit dhe disponimit te pasurise se saj ne perputhje me qellimin e objektit te veprimtarise qe kryen.

NENI 22

Detyrimet qe lindim gjate ushtrimit te veprimtarise se shoqerise, ajo i mbulon nga fondi reserve ose nga shumat suplementare.

NENI 23

Shoqeria gezon te gjitha te drejtat, per mbrojtjen e pasurise se saj, te parashikuara nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

V. PUNESIMI NE SHOQERI

NENI 24

Maredheniet juridike ndermjet shoqerise dhe personave qe punesohen ne te rregullohen ndermjet kontratave te punes bazuar ne kodin e Punes dhe dispozitat e tjera ligjore ne fuqi.

NENI 25

Shoqeria merr persiper, te shlyej rregullisht te gjitha detyrimet e saj qe burojne nga legjislacioni per sigurimet shoqerore e shendetesore lidhur me te punesuarit e saj.

VI. PRISHJA E SHOQERISE, LIKUJDIMI

NENI 26


Shoqeria prishet perpara kohe kur:

- Rezultati ekonomik i aktivitetit te saj per disa vite radhas eshte me humbje.
- Per shkaqe te pa parashikuara shprehimisht ne ligj.
- Ne çdo rast tjetër me vendim te ortakut te vetem.

NENI 27

Shoqeria mund te shpallet ne likujdim me vendim te ortakut te vetem te saj ose nepermjet nje vendimi nga gjykata ne baze te ligjit.

Ajo hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e marrjes se vendimit. Per realizimin e ketij procesi Ortaku ose Gjykata emerojne nje ose me shume likujdatore, te cilet pergatisin dhe paraqesin raportin permbylles



te aktivitet dhe pasivitet te shoqerise dhe bilanci perkates.

VII. KUSHTE TE TJERA

NENI 28

Te gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetem evidentohen ne nje liber te vecante, i cili administrohet ne seline e shoqerise.

NENI 29

Per te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organ kompetent per zgjidhjene tyre eshte Gjykata e Rrethit ku ka seline shoqeria, referuar legjislacionit shqiptar ne fuqi.

PER SHOQERINE "ORO TRADE" Sh.p.k.

ORTAKU I VETEM

NILÜFER UYAN

